



Viti i XII^{hë} i Botimit, Nr.1-2,
Dhjetor 2020

VËSHTRIM JURIDIKO-PENAL I FORMAVE TË VEÇANTA TË BASHKËPUNIMIT

Jonida Hyka *

* *Departamenti i Shkencave Juridike, Albanian University*

Adresë kontakti: j.hyka@albanianuniversity.edu.al

Përmbledhje

Qëllimi kryesor i këtij punimi do të jetë trajtimi i formave të veçanta të bashkëpunimit, dallimet e organizatës kriminale dhe grupit të strukturuar kriminal si dhe përkufizimin e organizatës terroriste sipas legjislacionit shqiptar. Krimi i organizuar është bërë problem shqetësues në shkallë ndërkombëtare dhe qëllimi kryesor është luftimi i tij, për të bërë gjithçka të mundur për ta parandaluar, pa dobësuar aspak luftën kundër tij. Edhe në Shqipëri ai qëndron në plan të parë të strategjisë së politikës shtetërore, për shkak të rrezikshmërisë së madhe shoqërore dhe të pasojave të rënda kriminale që sjell. Për luftimin e tij, shtete të ndryshëm, kanë hartuar ligje penale të posaçme, me sanksione të ashpra. Baza juridike e përpjekjeve të përbashkëta qëndron në Konventën e Kombeve të Bashkuara “Për krimin e organizuar ndërkombëtar“ në vitin 2000, e cila unifikoji konceptin e pikëpamjet për krimin e organizuar dhe synoi parandalimin dhe goditjen e kriminalitetit në përgjithësi dhe atij të organizuar në veçanti. Rezultatet tregojnë se janë me dhjetra rastet e arrestimit të pjesëtarëve të organizatave kriminale, ku shtetas shqiptarë e shtetas italian, në bashkëpunim kryejnë veprimtari të gjerë kriminale për trafikun e drogës apo të prostitucionit. Si përfundim, shteti shqiptar ka si detyrë luftën kundër krimit të organizuar, si një krim me rrezikshmëri të lartë shoqërore, për të realizuar një nga objektivat kryesore të tij, që është anëtarësimi në Bashkimin Europian. Integrimi është një proces historik që ka përpara sfida të shumta e të mëdha që mbeten për t’u kapërcyer.

Fjalë çelë: *Krimi i organizuar, organizata kriminale, organizata terroriste, banda e armatosur, Konventa e OKB-së.*

Abstract

The main aim of this paper will be the treatment of the specific forms of cooperation, changes of criminal organization and structured criminal group and the concept of the terrorist organization. Organized crime has become a concern problem on an international scale and

Jonida Hyka

a main goal is to fight him, to do everything possible to prevent it, without weakening the fight against him. Even in Albania it is the top priority of the strategy for state policy due to the high social dangerousness and serious criminal consequences that brings. For fighting it, different states have drafted special criminal laws, with harsh sanctions. The legal basis of the mutual attempts lies on the United Nations Convention “For International Organized Crime” of the year 2000 which unified the concept and the viewpoints about organized crime and aimed to prevention and the fight against criminality in general, and especially organized crime. The results show that there are dozens of cases of arrest of members of criminal organizations, where Albanian and Italian citizens, in collaboration carry out extensive criminal activities such as drug trafficking or prostitution. Finally, the Albanian state has a duty to fight against organized crime, as a crime with high social dangerousness, to realize one of his main objectives, that is membership in the European Union. Integration is a historical process that has numerous and major challenges ahead that remain to be overcome.

Key words: *organized crime, criminal organizations, terrorist organizations, armed gangs, the United Nations Convention.*

Hyrje

Krimi i organizuar është një nga format më të ashpra të kriminalitetit me të cilin po përballet shoqëria shqiptare. Realizimi i qëllimit të luftimit të tij, mund të bëhet në bazë të studimeve të kryera rreth kësaj dukurie nga studiues vendës dhe të huaj, të të dhënave statistikore të të gjitha organeve të përfshira në luftimin e tij si dhe të të dhënave të siguruara nga organet homologe në vendet fqinje, ku grupet kriminale shqiptare veprojnë ose bashkëpunojnë. Zbulimi dhe goditja e krimit të organizuar kërkon medeomos bashkëpunim dhe operacione të përbashkëta ndërmjet shteteve dhe kjo arrihet kur ato kanë të njëjtin koncept për krimin e organizuar. Me gjithë përmasat që mori krimi i organizuar në realitetin shqiptar, për një kohë të gjatë legjislacioni shqiptar nuk ka dhënë një përkufizim të nocionit “krim i organizuar”.

Përpyekjet e para për të dhënë një përkufizim të krimit të organizuar janë bërë në studime dhe artikuj të ndryshëm shkencorë të studiuesve shqiptarë. Në fillimet e vitit 1994, profesor Ismet Elezi e përkufizonte kriminalitetin e organizuar, si shkallën më të lartë të organizimit të kriminalitetit profesionist dhe me krim të organizuar nënkupton krijimin e grupeve dhe të bandave të ndryshme të organizuara që bashkëpunojnë në mënyrë të rregullt për kryerjen e veprave penal (1). Një studiues tjetër shqiptar, Zamir Poda, duke dashur të japë një përkufizim për krimin e organizuar, thekson: të flasësh për të, para së gjithash duhet të flasësh për MAFIEN, si një organizim kriminal (2).

Dihet që mungesa e përkufizimit për një vepër penale sjell vështirësi në marrjen e masave për parandalimin dhe dënimin saj. Ndaj ky problem mori zgjidhje në vitin 2002 kur parlamenti shqiptar me ligjin 8920, datë 11.07.2002 ratifikoi Konventën e OKB-së “Kundër krimit të organizuar ndërkombëtar” dhe dy protokollet shtesë të tij (3).

1- protokollin “Kundër trafikimit të emigrantëve në rrugë tokësore, ajrore dhe detare” dhe 2-protokollin “Për parandalimin, pengimin dhe ndëshkimin e trafikut të personave, veçanërisht grave dhe fëmijëve” Ratifikimi i kësaj konvente e bën atë pjesë përbërëse të legjislacionit shqiptar dhe, për rrjedhojë, përcaktimi që neni 2 i konventës i bën grupit kriminal të organizuar dhe termave të tjerë që kanë lidhje me të, kanë zgjidhur problemin e nocionit krim i organizuar, në Shqipëri (4).

Këto akte juridike ndërkombëtare janë bazë juridike për shtesat dhe ndryshimet e bëra në Kodin Penal. Në bazë të Kushtetutës shqiptare, ratifikimi i konventës dhe dy protokollet shtesë të saj, bëhen automatikisht pjesë e legjislacionit të brendshëm. Kjo do të thotë që Shqipëria ka pranuar si përkufizim të krimit të organizuar në legjislacionin e saj penal përkufizimin e dhënë nga OKB-ja në konventën “Kundër krimit të organizuar ndërkombëtar”. Krimi i organizuar karakterizohet nga një diversitet kriminal për vetë faktin se aty përfshihen më shumë se një lloj krimi. Ai konsiston në trafikun e drogës, armëve, qenieve njerëzore dhe kryesisht femrave, emigrim ilegal, etj. Pra, veprimtaria e tyre është më tepër e përhapur në ato forma krimi që sjellin përfitim monetar dhe material në një kohë të shkurtër.

Edhe Bashkimi Europian më 21 dhjetor 1999 ka dhënë këtë përkufizim të organizatës kriminale: “Me organizatë kriminale kuptohet një organizatë që ka strukturë të përbërë nga dy ose më shumë persona që veprojnë për një kohë të gjatë së bashku për të kryer krime, për të cilat ligji parashikon një minimum prej të paktën katër vjet burgim ose dënime më të rënda, kur këto vepra kanë për qëllim nxjerrjen e përfitimeve materiale dhe kur është e mundur të ndikojë indirekt mbi veprimet e autoriteteve publike”.

Në dallim nga formulimi i mëparshëm i nenit 28 të Kodit Penal, ku jepej një përkufizim i ngushtë i organizatës kriminale që “përfaqëson shkallën më të lartë të bashkëpunimit për kryerjen e veprimtarisë kriminale të qëndrueshme”, me ligjin nr.9275 datë 16.9.2004 u ndryshua neni 28 i Kodit penal. Konkretisht bëhet ky përkufizim:

“Organizata kriminale është forma më e lartë e bashkëpunimit, në të cilën bëjnë pjesë tre ose më shumë persona dhe që dallohet nga shkalla e veçantë e organizimit, strukturimit, qëndrueshmërisë, kohëzgjatjes si dhe nga qëllimi, për kryerjen e një a më shumë veprave penale, për të realizuar përfitime materiale dhe jo materiale (neni 28 p.1) (5).

Po në këtë nen flitet, edhe për përgjegjësinë penale të antarëve të organizatës kriminale,

Jonida Hyka

organizatës terroriste, bandës së armatosur dhe grupit të strukturuar kriminal për të gjitha veprat penale të kryera prej tyre. Ndryshimet dhe shtesat e bëra me ligjin nr. 9275, datë 16.09.2004, si dhe me ligjin nr.9686, datë 26.02.2007, si në pjesën e përgjithshme, ashtu dhe në pjesën e posaçme të Kodit Penal kanë rëndësi parimore, sepse bëjnë formulime të reja të formave të veçanta të bashkëpunimit, me qëllim që të goditet më me efektivitet krimi i organizuar në Shqipëri, si problem shqetësues.

I. Karakteristikat e organizatës kriminale

Bazuar në përkufizimet e dhëna të organizatës kriminale në pjesën e përgjithshme të Kodit Penal (neni 28), të ndryshuar me ligjin nr.9275 datë 16.9.2004, në pjesën e posaçme të tij konkretisht në nenin 333 të Kodit Penal, parashikohet përgjegjësia penale për veprat penale të kryera prej tyre. Sqarimi i elementëve përbërës të figurës së krimit të parashikuar nga neni 333 i Kodit Penal lidhet drejtpërdrejt me karakteristikat kryesore të organizatës kriminale, e sidomos me anën objektive, subjektin dhe anën subjektive të saj. Kërkesat e anës objektive janë:

Së pari, në organizatën kriminale bëjnë pjesë jo më pak se tre persona. Kjo parashikohet shprehimisht në nenin 28 të Kodit Penal (p.1).

Së dyti, organizata kriminale ka një shkallë të lartë organizimi, strukturimi, qëndrueshmërie dhe kohëzgjatje. Organizata kriminale ka hierarki të caktuar, detyra dhe role të ndara, një plan kriminal të përcaktuar, ku parashikohet veprimtaria kriminale dhe realizimi i planit në kohë e në hapësirë, lidhje dhe bashkëpunim me segmente të caktuara të administratës publike si dhe me policinë, prokurorinë, gjykatën etj, nxjerrja e përfitimeve të mëdha ekonomike, nëpërmjet pastrimit të parave, lidhje dhe bashkëpunim me Mafien ndërkombëtare (6). Mafia shqiptare, siç quhet nga të huajt, vepron në lidhje të ngushtë e në bashkëpunim me mafien italiane, si: Kosa Nostra, Kamorra, Santa Corona Unita. Këto lidhje tashmë janë zbuluar e vërtetuar plotësisht nga organet shtetërore italiane dhe praktika e vendit tonë me arrestimin pjesëmarrësve të organizatave kriminale shqiptaro-italiane për trafikimin e qenieve njerëzore, të fëmijëve, të femrave për ushtrim prostitucioni, të drogës, të armëve, lëndëve plasëse dhe i municioneve. Sipas të dhënave të policisë, trafiku i drogës nisët nga Afgani-stani, Turqia, Maqedonia, për në Shqipëri dhe arrin në Itali nëpërmjet trafikantëve të organizuar në organizata kriminale të disa shteteve.

Së treti, personat që bëjnë pjesë në organizatën kriminale për kryerjen e një a më shumë veprave penale, përdorin forcën, mjetet e tjera të kërcënimit, nënshtrimin dhe heshtjen për pjesëmarrjen në të.

Së katërti, sigurojnë në çdo mënyrë, administrimin ose vënien nën kontroll të veprimtarisë ekonomike, të konçesioneve, autorizimeve, sipërmarrjeve dhe shërbimeve publike.

Krimi i organizuar vepron në kuadrin e krimit profesional, për të nxjerrë fitime sa më të mëdha, materiale dhe jo materiale, aq sa të ardhurat e organizatave kriminale mund të tronditin thellë buxhetin e shtetit, ashtu sic ndodhi me firmat piramidale mashtruese.

Subjekt i krimit janë krijuesit, organizatorët, drejtuesit dhe pjesëmarrësit e organizatës kriminale. Karakteristikë tjetër themelore nga ana subjektive është se veprimtaria e organizatës kriminale kryhet për të realizuar përfitime materiale a jomateriale ose avantazhe të padrejta për vete dhe persona të tjerë, pavarësisht se në formulimin e nenit 333, kjo karakteristikë nuk përmendet shprehimisht, por ajo është themelore për organizatën kriminale që parashikon neni 25 i KP. Shtypi, media elektronike dhe opinionin japin alarmin për përmasat e mëdha dhe format e krimit të organizuar të pleksura me korrupsion. Vërehet një paradoks i madh në praktikën hetimore e gjyqësore, ku nuk procedohen e gjykohen të gjithë. Janë me dhjetra rastet e arrestimit nga policia italiane të pjesëtarëve të organizatave kriminale me shtetas shqiptarë e shtetas italianë, që në bashkëpunim kryejnë veprimtari të gjerë kriminale për trafikun e drogës apo të prostitucionit (7).

Shtesat e ndryshme në Kodin Penal, nga ku mund të përmendim nenin 284/a të Kodit Penal për lëndët narkotike e psikotrope i cili ka për qëllim të gadasë më me ashpërsi vepra penale të tilla, qofshin ato organizatorët, drejtuesit dhe financuesit të organizatës kriminale apo pjesëmarrës të thjeshtë në to. Për trajtimin e këtij problemi, Kodi Penal i Shqipërisë ka pasur si model Kodin Penal të Italisë (neni 476) dhe Kodin Penal të Francës si për sa i përket kuptimit të organizatës kriminale që merret me drogë, ashtu dhe për ashpërsimin e dënimit penal. Kodi Penal në fuqi parashikon dënimin me burgim deri në 20 vjet, kurse Kodi Penal Italian deri në 26 vjet dhe Kodi Penal Francez deri në 30 vjet burgim (8).

II. Dallimet e organizatës kriminale dhe grupit të strukturuar kriminal

Për shkak se deri tani në teorinë e së drejtës penale të Shqipërisë ende nuk janë bërë studime të posaçme lidhur me formulimet e reja të formave të veçanta të bashkëpunimit, duke filluar nga organizata kriminale e deri te grupi i strukturuar kriminal, kanë lindur mjaft vështirësi për të bërë dallimet midis tyre dhe sidomos për zbatimin e drejtë në praktikë.

Kështu për të bërë dallimet midis organizatës kriminale dhe grupit të strukturuar kriminal është e nevojshme të mbahen parasysh ato elementë që janë të përbashkët dhe të dallueshëm (9):

Së pari, si në organizatën kriminale dhe në grupin e strukturuar kriminal pjesëmarrja e tre ose më shumë personave është e njëjlojtë dhe nuk ka ndonjë dallim.

Së dyti, si organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal krijohen për të kryer një ose

Jonida Hyka

më shumë vepra penale. Pra edhe në këtë drejtim nuk ka ndonjë dallim.

Së treti, organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal krijohen e veprojnë për të realizuar përfitime materiale ose jo materiale, kështu që nuk ka dallim midis tyre.

Së katërti, dallimi midis tyre qëndron vetëm në shkallën e organizimit, të strukturës, qëndrueshmërisë dhe kohëzgjatjes (10).

Këto karakteristika kryesore të organizatës kriminale përbëjnë edhe dallimin midis këtyre karakteristikave për të arritur në përfundim nëse ndodhemi para kriminit të organizatës kriminale apo grupit të strukturuar kriminal, që ndesh në jo pak vështirësi interpretimi. Vështirësi tjetër e madhe është se si duhen marrë karakteristikat e organizatës kriminale të gjitha së bashku, apo mjafton një apo dy prej tyre për të bërë cilësime të rregullta ligjore. Mendoj se të paktën tre karakteristikat kryesore: numri i pjesëmarrësve (jo më pak se tre), shkalla e lartë e organizimit, qëndrueshmërisë dhe kohëzgjatja, duhen marrë të tria së bashku.

Antarët e organizatës kriminale, të organizatës terroriste, bandës së armatosur ose grupit të strukturuar kriminale janë përgjegjës për të gjitha veprat penale, të kryera prej tyre, në përmëshjen e qëllimeve të veprimtarisë së tyre kriminale. Në nenin 28 të Kodit Penal paragrafi i shtatë parashikohet shprehimisht se pjestari i organizatës kriminale, organizatës terroriste, bandës së armatosur ose i grupit të strukturuar kriminal, përfiton përjashtimin nga dënimi ose uljen e tij, kur jep ndihmesë, që gjykohet vendimtare për njohjen e veprimtarisë së tyre, të bashkëpunorëve të tjerë, pasurive të zotëruara drejtpërdrejt ose jo prej tyre, si dhe për veprimtaritë hetimore, që zhvillohen ndaj organizatave kriminale, organizatave terroriste, bandave të armatosura dhe grupeve të strukturuar kriminale (11). Kjo është një dispozitë favorizuese vetëm për ata që pendohen, por ka edhe efekte pozitive parandaluese. Gjithashtu një shtesë e rëndësishme që është bërë në Kodin Penal është neni 52/a me ligjin nr.144/2013. Konkretisht në pragrafin e fundit në të këtij neni thuhet shprehimisht se për vepra penale të kryera nga personi që është pjesëtar i organizatës kriminale, nëqoftëse bashkëpunon dhe ndihmon organet e ndjekjes penale në luftën kundër tyre ose, sipas rastit, në zbulimin e personave të tjerë, që kryejnë krime të tilla, nuk mund të dënohet më tepër se gjysma e dënimit të parashikuar për veprën e kryer prej tij. Në raste të veçanta, kur konkurojnë edhe rrethana lehtësuese në favor të tij, ky person mund të përjashtohet nga dënimi. Kjo është një dispozitë që ka si qëllim primar, zbulimin dhe parandalimin kriminit të organizuar.

Parandalimi dhe luftimi i grupeve të strukturuar kriminale, që zhvillojnë veprimtarinë e tyre kriminale, sidomos në kryerjen e vjedhjeve, falsifikimeve, kontrabandës, janë detyra të vazhdueshme të organeve të specializuara të shtetit. Fakt është se këto forma të veçanta

të bashkëpunimit ndeshen më shpesh në praktikë dhe shkaktojnë pasoja të rënda, sidomos në fushën e pasurisë e të ekonomisë publike e private. Nga analiza e formave të veçanta të bashkëpunimit dhe të veprave penale të kryera prej tyre, sipas shtesave e ndryshimeve të bëra në Kodin Penal, me reformën ligjore të vitit 2004, dalin në pah karakteristika kryesore. Shtesat dhe ndryshimet e bëra në Kodin Penal ishin të nevojshme dhe të dobishme për goditjen e krimit të organizuar në përgjithësi dhe të krimeve të kryera në format e veçanta të bashkëpunimit.

III. Organizata terroriste

Me ligjin nr. 9275, datë 16.09. 2004, për herë të parë në nenin 28 të Kodin penal është dhënë përkufizimi i organizatës terroriste.

Organizatave terroriste janë bërë problem tepër shqetësues në mjaft vende të botës për sigurinë e rendit shoqëror. Për herë të parë, përpjekjet për të përkufizuar terrorizmin janë dhënë nga organizata e lidhjes së kombeve, më 1937 (12). Edhe legjislacioni ynë penal ka bërë hapa pozitiv duke i sanksionuar aktet terroriste dhe financimet e tyre si të kundraligjshme (13). Terrorizmi përfaqëson formën më të rëndë të kriminalitetit në ditët tona. Ai përbën një kërcënim në mbarë botën. Aktet terroriste janë rritur në kuadër të globalizimit, të rritjes së teknologjisë dhe komunikacionit. Pavarësisht se sot ka mendime të ndryshme rreth përkufizimit të aktit terrorist, ai vlerësohet si një akt ekstrem i përdorimit të dhunës për të ndikuar në zhvillime politike të caktuara në një vend. Megjithatë legjislacione të shumë vendeve, përfshirë edhe atë shqiptar, parashikojnë si akt terrorist edhe vepra kriminale që kanë për qëllim përfitime materiale personale, siç mund të jetë marrja peng e një autobusi për të grabitur pasagjerë. Sipas Paul Wilkinson këto vepra duhen veçuar nga aktet e vërteta terroriste të kryera për qëllime politike, ideologjike dhe kohët e fundit fetare (14). Në shtetin tonë është ratifikuar konventa "Për shtypjen e terrorizmit", ku bazohet edhe Kodi Penal (15). Në vazhdim të shtesave dhe ndryshimeve të bëra me këtë ligj, rëndësi të posaçme ka edhe lufta kundër financimit të terrorizmit, si fenomen tjetër ndërkombëtar dhe si një ndër përparësitë e politikës kriminale të shtetit tonë. Për këtë është miratuar ligji nr.9258, datë 15.07.2004 për financimin e terrorizmit. Qëllimi i këtij ligji është parandalimi dhe goditja e terroristëve, organizatave terroriste dhe atyre që mbështesin e financojnë terrorizmin, duke sekuestruar fondet dhe pasuritë e tyre, nëpërmjet zbatimit të rezolutave të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, përfshirë ato me nr. 1267, 1333, 1373, 1390, 1455, si dhe në raste të tjera sipas parashikimeve të këtij ligji. Ligji përcakton kushtet procedurat, kontrollin, masat kundër financimit të terrorizmit. Pikërisht për këtë arsye, luftimi i organizatave terroriste aktualisht ka dalë në plantë parë dhe në të janë angazhuar shumë shtete, përfshirë edhe shtetin shqiptar.

Jonida Hyka

Parandalimi dhe luftimi i tyre mbetet detyrë parësore e shtetit të së drejtës dhe e mbarë shoqërisë shqiptare.

Përfundime

1. Krahas përmirësimeve e plotësimeve eventuale në Kodin Penal, për parandalimin dhe luftimin e veprave penale të kryera nga format e veçanta të bashkëpunimit, rëndësi kryesore ka organizimi dhe bashkërendimi i veprimtarisë së organeve të prokurorisë me ato të policisë e të organeve të tjera, si dhe me shoqërinë civile e median, duke krijuar një front të përbashkët. Për këtë del detyra të merren masa të gjithanshme organizative, reforma strukturore, teknike dhe trajnime për kualifikimin e kuadrit të specializuar (16).

2. Organizatat kriminale, organizatat terroriste, bandat e armatosura dhe grupet e strukturuar kriminale, si dhe krimet e kryera prej tyre mund të parandalohen, zbulohen e dënohen vetëm në rast se vihet në baza të forta bashkëpunimi i organeve të policisë, prokurorisë, gjykatës me institucionet e posaçme të shteteve të tjerë, sidomos të atyre fqinje, si dhe me INTERPOL-in, EUROPOL-in etj.

3. Në dhjetëvjeçarin e fundit shoqëria shqiptare po përballet me fenomene të tilla negative si krimi i organizuar, trafiqet e paligjshme, pastrimi i parave, korrupsioni etj. Këto probleme janë shqetësuese jo vetëm në vendin tonë, por edhe në shtete të tjera europiane. Prandaj është e nevojshme marrja e masave të menjëhershme për zbulimin dhe goditjen e këtij kriminaliteti.

4. Në këtë kuadër janë miratuar një varg ligjesh, me të cilët janë bërë shtesa dhe ndryshime në Kodin Penal për të bërë sa më efikase luftën ndaj krimit të organizuar. Një nga këto ligje është dhe ai me nr. 9275 dt. 16.9.2004, i cili parashikoi format e veçanta të bashkëpunimit: organizatën kriminale, organizatën terroriste, bandën e armatosur dhe grupin e strukturuar kriminal.

5. E fundit por me rëndësi është parandalimi dhe luftimi i veprave penale të kryera nga format e veçanta të bashkëpunimit. Në stadin aktual në të cilin ndodhet Shqipëria, kur vazhdon procesi i ndërtimit të shtetit të së drejtës format, sasia e cilësia e kriminalitetit paraqesin problem, orientimi themelor i së drejtës sonë penale mbetet filozofia liberale - demokratike, mbrojtja e të drejtave dhe lirive të njeriut, si dhe parandalimi e goditja me ashpërsi e krimeve të rënda posaçërisht e krimit të organizuar. Ky duhet të jetë prioriteti i shtetit shqiptar dhe organeve shtetërore të tij. Rëndësi kryesore ka organizimi dhe bashkërendimi i veprimtarisë së gjykatës, prokurorisë, policisë dhe komunikimi me shoqërinë civile, për ndërgjegjësimin e saj ndaj rrezikut të lartë të këtyre formave të kriminalitetit.

Referenca

1. Elezi, I., “Leksione për kriminologjinë”, Tiranë, 1994, f.72.
2. Poda, Z., “Krimi i organizuar”, ShBLU, Tiranë, 1998, f.5.
3. Konventa e OKB-së “Për krimin e organizuar ndërkombëtar”, 1953, botuar në përmbledhje aktesh juridike për drejtësinë, Tiranë, 2000.
4. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Tiranë, 1998, neni 122.
5. Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare, Alb Juris, Tiranë, 2017, f. 19-20.
6. Elezi, I, Komentari i shtesave dhe ndryshimeve të reja në Kodin penal 2003-2004, Albin, Tiranë, 2004, f.207-210.
7. Elezi, I, Zhvillimi historik i mendimit juridik shqiptar, SHBLU, Tiranë, 2010, f.222-224.
8. Konventa kundër trafikimit të paligjshëm të drogave narkotike dhe substancave psiko-trope, botuar në përmbledhje e akteve juridike ndërkombëtare për drejtësinë, Tiranë 2006.
9. Elezi, I., Kaçupi, S., Haxhia, M, “Komentari i Kodit Penal të RSH”, Kumi, Tiranë, 2017, f.212-217.
10. Koça, A, Grupi i strukturuar kriminal – si formë e veçantë e bashkëpunimit, Studime Juridike, N.2, 2005, f.192-200.
11. Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare, Alb Juris, Tiranë, 2017, f. 20.
12. Lidhja e kombeve, Masa për eliminimin e terrorizmit ndërkombëtar, rezolutë nr. 51/210, 1937.
13. Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare, Alb Juris, Tiranë, 2013, f. 115-122.
14. Bovenkerk, F; Chakra, B, Terrorism and organized crime, Forum on crime and Society, vol. 4, nr.1, f.3.
15. Konventa Europiane, për shtypjen e terrorizmit, botuar në përmbledhje aktesh juridike ndërkombëtare, Tiranë, 2006.
16. Shala.XH, Krimi i organizuar, siguria kombëtare dhe sfidat e integritetit, Qendra Shqiptare e Studimeve për Sigurinë Kombëtare, Tiranë, 2003, f.26-29.